



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.01.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin e rregullores “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Emona Muçi*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Irena Plaku*** (anëtare)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)

10. Markelian Koça (anëtar)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.

4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.

6. Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.

7. Përfaqësues i EU4Justice.

8. Staf nga administrata e KLGJ-së.

9. BIRN.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin e rregullores “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë””, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës, të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 24 janar.

Siç jeni në dijeni, sot nga ana e Këshillit do të shqyrtohen 12 çështje.

Paraprakisht kam një propozim që çështjet nr. 3 dhe nr. 5, që bëjnë fjalë për miratimin e rregulloreve për përdorimin e postës elektronike zyrtare në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe sistemin gjyqësor, si dhe për mënyrën e përdorimit të teknologjisë audio/vizive në procesin gjyqësor, t’i shtyjme për një mbledhje të ardhshme, pasi duhet që fillimisht t’ia kalojmë për një mendim të specializuar gjykatave, IT-ve të gjykatave,

por pse jo, edhe kryetarëve dhe kancelarëve të gjykatave. Jemi dakord?

(Anëtarët e Këshillit bien dakord që çështja me nr.3 e renditur në rendin e ditës dhe çështja me nr. 5, të dalin nga rendi i ditës, për t'u shqyrtuar në një mbledhje të ardhshme.)

Naureda Llagami: Atëherë, pa humbur kohë fillojmë me çështjen e parë që në fakt ka të bëjë me miratimin e rregullores “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë”.

Siç jeni në dijeni, kjo rregullore vjen në vijimësi të të gjithë kuadrit ligjor të zhvillimit të karrierës dhe llogaridhënies së nëpunësve gjyqësorë civilë. Këshilli ka përfunduar tashmë aktet që kanë të bëjnë me kancelarët dhe ndihmësit ligjorë, dhe kemi të bëjmë me rregulloren tjetër që bën fjalë për të gjithë nëpunësit civilë gjyqësorë (jo kancelarë dhe jo ndihmës ligjorë).

Kjo rregullore është bërë nga një grup dhe është marrë asistencë edhe nga projektet që asistojnë Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe do raportohet këtu nga Drejtoresha e Departamentit të Burimeve Njerëzore, znj. Etrita. Shkurtimisht mbi përmbajtjen e rregullores dhe çfarë do të synojë kjo.

Etrita Petriti: Të nderuar!

Në mbështetje të nenit 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, neneve 69 dhe vijues të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neneve 61, 90 dhe 97, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, si dhe në mbështetje të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, është hartuar projektvendimi për miratimin e rregullores “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë”.

Kjo Rregullore ka për qëllim vendosjen e një seti rregullash të hollësishme për procedurat disiplinore për nëpunësit civilë gjyqësorë.

Kjo Rregullore përbëhet nga 6 Krerë dhe 31 nene, si më poshtë:

Kreu I, i cili përmban dispozita të përgjithshme është i organizuar në 5 Nene.

Në nenin 1, i cili përkufizohet “Qëllimi i Rregullores”, parashikohen parimet dhe

rregullat e përgjithshme për zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj nëpunësve civilë gjyqësorë.

Në nenin 2, i cili përkufizohet “Objekti i Rregullores”, parashikohet se ky vendim përcakton rregullimin e procedurave të zbatueshme gjatë verifikimit të ankesave të paraqitura nga çdo person fizik dhe juridik, apo çdo nëpunës apo punonjës tjetër i gjykatës ndaj nëpunësve civilë gjyqësorë dhe hetimit të shkeljeve disiplinore si dhe propozimin për fillimin e procedimit disiplinor, shqyrtimin e procedimeve disiplinore dhe vendimmarrjeve në lidhje me to.

Në nenin 3, përcaktohet kuptimi i termave referuese të rregullores.

Në nenin 4, i cili përkufizohet “Parimet e procedurave disiplinore”, parashikohen parimet bazë mbi respektimin e të cilave zhvillohen procedura disiplinore ndaj nëpunësve civilë gjyqësorë.

Në nenin 5, i cili përkufizohet “Procedurat disiplinore”, parashikohen fazat/ etapat që realizohen gjatë zhvillimit të një procedure disiplinore, deri në finalizim të saj me vendimmarrje.

Në Kreun II i cili përmban dispozita mbi procedurat hetimore që zhvillohen paraprakisht në një procedurë disiplinore, është i organizuar në 10 nene.

Në nenin 6 dhe 7, të cilët përkufizohen “Ankesa dhe kriteret për pranueshmëri” dhe “Shqyrtimi paraprak i ankesës”, parashikohen elementët e ankesës, struktura e cila shqyrton ankesën si dhe fazat nëpër të cilat kalon shqyrtimi i ankesës deri në momentin e vendimmarrjes mbi të.

Në nenet 8-14, parashikohen të gjitha fazat e procedurës së hetimit, duke përcaktuar qartë momentin e fillimit të hetimit – struktura përgjegjëse për fillimin e hetimit- vendimmarrja për fillimin e hetimit, pezullimi i tij ku përcaktohet struktura përgjegjëse - momenti i pezullimit të hetimit, dokumentacioni mbi të cilin pasqyrohen të gjitha veprimet e kryera, si përfundimi/mbyllja/rihapja e hetimit disiplinor, ku përcaktohen detyrat e strukturës përgjegjëse, kushtet dhe afatet, shkak për mbylljen apo rihapjen e një hetimi disiplinor.

Në nenin 15, i cili përkufizohet “Ankimi i mosveprimit administrativ”, parashikohet e drejta e ankimit të nëpunësit civil gjyqësor pranë KLGJ-së për

mosveprime administrative.

Kreu III i këtij akti i organizuar nga 11 nene, i dedikohet në tërësi zhvillimit të procedurës disiplinore nga momenti i paraqitjes së kërkesës për fillim procedimi disiplinor ndaj një nëpunësi civil gjyqësor deri në finalizimin e procedurës me vendimmarrje të strukturës kompetente.

Në këtë Kre detajohen të drejtat dhe detyrat e nëpunësit civil gjyqësor subjekt procedimor, organi kompetent për shqyrtimin e procedimit disiplinor, mënyra e zhvillimit të procedimit disiplinor, vendimmarrja si dhe e drejta e ankimit ndaj vendimit.

Në Kreun IV i cili është i organizuar në 2 nene më konkretisht neni 27 dhe neni 28 parashikohet pezullimi nga detyra e nëpunësit civil gjyqësor, subjekt procedues gjatë hetimit ose procedimit disiplinor. Parashikohet struktura e cila mund të paraqesë/kryesisht kërkesë për pezullim nga detyra, vendimmarrja dhe afatet e saj, mbi këtë kërkesë, si dhe mënyra e pagesës së nëpunësit civil gjyqësor, subjekt procedimor gjatë periudhës së pezullimit nga detyra.

Në Kreun V, i cili është i organizuar në 2 nene, më konkretisht neni 29 dhe neni 30 parashikohet ekzekutimi i masës disiplinore si dhe arkivimi i praktikës dokumentare mbi të gjithë procedurën e zhvilluar.

Në Kreun VI, i cili përmban nenin 31, parashikohet Modeli i formularit të ankesës, i cili miratohet sipas afatit të përcaktuar nga Këshilli i çdo gjykate dhe publikohet në faqen zyrtare të gjykatës.

Komente të Përgjithshme mbi aktin

Akti i konceptuar si një tërësi rregullash (rregullore), ka për qëllim plotësimin e bazës ligjore për mirëfunksionimin e administratës së gjykatës, për përgjegjësitë e nëpunësve civilë gjyqësorë mbi veprimtarinë e tyre funksionale.

Për sa më sipër në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet, miratimi i “Rregullores për zhvillimin e procedurave disiplinore për nëpunësit civilë gjyqësore”, sipas aktit bashkëlidhur.

Në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Etrita, zoti Kurushi ka vetëm një diçka.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Vetëm një pyetje, asgjë më tepër. Vetëm për t'u konsultuar ndoshta me veten time. Në të gjithë rregulloren janë përmendur nocionet, termat “kancelar” si organ që fillon procedimin dhe “këshilli i gjykatës”, apo jo?

Po të shkojmë tek neni 9 ‘pezullimi i hetimit dhe procedimi disiplinor’, vetëm këtu gjendet termi “organ kompetent”. Pse është shënuar organ kompetent? Se mos ngatërrohen nesër në praktikë kolegët. Ka kuptimin që pezullimi i hetimit dhe i procedimit disiplinor bëhet edhe nga kancelari në varësi të fazës ku ndodhet procedimi, edhe nga këshilli? Kjo është arsyeja?

Etrita Petriti: Është parashikuar “organ kompetent” në varësi të momentit që ndodhet procedimi disiplinor. Në qoftë se jemi para fillimit të procedimit disiplinor, mund të jetë kancelari, dhe më pas në qoftë se jemi gjatë zhvillimit të procedimit, do të jetë këshilli i gjykatës.

Në qoftë se mund të bëjmë një korrigjim, bëjmë “kancelari ose këshilli i gjykatës”, duke dhënë edhe momentet.

Naureda Llagami: Jemi dakord me propozimin, ta reflektojë tek akti?

Ndonjë sugjerim tjetër nga kolegët?

Nëse nuk kemi, atëherë hedhim në votim bashkë me sugjerimin që pati zoti Kurushi, i cili do të zbardhet dhe do të reflektohet tek neni 9.

Kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e Rregullores “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për nëpunësit civilë gjyqësorë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.01.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për krijimin e “e-mail server” për postën elektronike zyrtare të sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Emona Muçi*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Irena Plaku*** (anëtare)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
10. ***Markelian Koça*** (anëtar)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.*
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 6. Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
- 7. Përfaqësues i EU4Justice.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 9. BIRN.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për krijimin e “e-mail server” për postën elektronike zyrtare të sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i dytë i cili do të relatohet nga z. Greca, i cili shkurtimisht do të na thotë nevojën e miratimit të këtij projekt-akti nga ana e Këshillit.

Kelment Greca: Përshëndetje të nderuar anëtarë!

Relacioni për miratimin e projektvendimit “Për krijimin e “e-mail server” për postën elektronike zyrtare të sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” –

Me shkresat nr. 4896/1 prot., datë 12.10.2023, jemi njoftuar nga AKSHI se (aktualisht e-mailet e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe gjykatave hostohen nga AKSHI)

“...duke qenë se Këshilli i Lartë Gjyqësor është një institucion i pavarur i cili ka nën varësi një institucion teknik për të mbuluar kërkesat teknike, kërkojmë që nga ana juaj të merren masat që email-et të hostohen diku tjetër, nisur nga data 1 dhjetor.”

Kemi pasur një komunikim zyrtar nga AKSHI dhe kemi arritur në marrëveshjen që do hostohen nga AKSHI deri në datën 28 shkurt 2024.

Me projektbuxhetin e vitit 2024 Këshilli ka miratuar një buxhet për investimin e këtij projekti dhe lind nevoja e miratimit të një projektvendimi për krijimin e e-mail serverit që të vazhdojmë punën për hostimin e e-maileve të Këshillit dhe të gjykatave për data “center-in” e KLGJ-së.

Vendimi përbëhet nga dy pika.

Pika 1 është krijimi dhe tjetra është ngarkimi i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit për zbatimin e këtij vendimi.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Po, zoti Toro!

Alban Toro: Atëherë, Keli, vazhdimisht kemi diskutuar në lidhje me sigurinë dhe çështja e sigurisë në këtë fushë është jashtëzakonisht aktuale, pasi së fundmi ne kemi pasur raste në institucione të caktuara ku siguria kibernetike është cenuar në atë farë mënyre sa që ka krijuar edhe bllokim të sistemit.

Pra natyrshëm që jam për të ikur nga AKSHI, por të shikohet eventualisht edhe mundësia që të kërkojmë një hostim profesional në “iCloud”. Besoj krijon një siguri më të mirë, sepse ajo shpërndahet në disa servera dhe mundësisht të gjendet provider-i i cili të ketë apo të disponojë apo të ofrojë disa nivele sigurie. Po të duash t’i citoj nga ana teknike, por nuk besoj se do të jetë e kuptueshme për ata që na dëgjojnë. Pra bëhet fjalë për “E2EE - end to end encryption” apo “ + 0 access encryption” dhe niveli tjetër është ky që ju keni përmendur që është me “two-factor authentication (2FA)”, që është jashtëzakonisht i mirë. Të tria këto nivele besoj që krijojnë një farë sigurie të tillë dhe unë do të mendoja (nuk e di se sa është e realizueshme), prandaj u kërkuar edhe ajo pjesa tjetër

e diskutimeve për e-maillet që të hidhen tek aktorët për t'u diskutuar, në mënyrë të veçantë IT-të, pra do të isha për një shpërndarje për hostimin profesional nëpërmjet "iCloud"-eve, të shikohet edhe kjo si mundësi. Unë besoj që kostoja ia vlen për sigurinë që ofron. Gjithsesi i takon teknikës që ju mbulon që të thotë fjalën e fundit dhe të na thotë edhe neve një sqarim në këtë kuadër që a është e tillë, krijon të tillë siguri dhe a ia vlejné kostot për ta përballuar? Dhe ne do kërkojmë kostot përkatëse, mjafton që serverat t'i kemi të siguruar për çdo lloj penetrimi nga jashtë.

Klement Greca: Atëherë, në përgjigje të pyetjes tuaj, ka dy gjëra që ne na pengojnë që të bëjmë hostimin në "iCloud" të e-maileve zyrtare. Është një udhëzim i Komisionerit për Mbrojtjen që thotë që nuk e lejon hostimin e e-maileve zyrtare në "Cloud", e dyta, është kosto shumë e lartë e hostimit në "Cloud". Ne kemi parashikuar tek projekti ynë vetëm sistemin e mbrojtjes në "Cloud".

Alban Toro: Çfarë "firewall" keni?

Klement Greca: Kemi "Cisco firewall".

Alban Toro: "Cisco", që do të thotë është operativ vetë?

Klement Greca: Është shumë i mirë. Po, cilësia është shumë e lartë.

Alban Toro: Është "hardware" me operativ brenda.

Klement Greca: Janë të dyja brenda. E ka edhe "hardware" edhe "software" janë "Cisco".

Alban Toro: Është edhe operativ?

Klement Greca: Po!

Alban Toro: Çështja e kostos është gjë që na shqetëson neve.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim, përveç zotit Toro, i cili ishte në formën e një sugjerimi që të mbahet parasysh nga departamenti?

(Nuk ka diskutime.)

Kalojmë në miratimin e projekt-aktit?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Krijimin e “e-mail server” për postën elektronike zyrtare të sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

2. Ngarkohet Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohen në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.01.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 426, datë 14.10.2022 “Për miratimin e listave tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve gjyqësore që arkivohen në gjykata””, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Emona Muçi* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Irena Plaku* (anëtare)
8. *Alban Toro* (anëtar)

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 4-ta sipas rendit të ditës. Shih procesverbalin e pikes së parë, pasi pikat nr. 3 dhe nr. 5 u shtynë dhe nuk u trajtuan, për rrjedhojë ndryshon renditja.

9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
10. *Markelian Koça* (anëtar)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
6. *Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
7. *Përfaqësues i EU4Justice.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
9. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 426, datë 14.10.2022 “Për miratimin e listave tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve gjyqësore që arkivohen në gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Vijomë prapë me aktet e Komisionit të Administrimit të Buxhetit, akti tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 426, datë 14.10.2022 “Për miratimin e listave tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve gjyqësore që arkivohen në gjykata”. Iniciativa për ndryshimin e këtij vendimi ka ardhur nga kërkesa e sjellë nga Prokuroria e Përgjithshme mbi sugjerimet që kanë mbi afatet për ruajtjen, e listës tip. Megjithatë, për

më shumë detaje fjalën ia jap zërish zotit Greca.

Kelment Greca: Faleminderit!

Atëherë, projektvendimi i dytë është për një ndryshim në vendimin nr. 426, datë 14.10.2022, të Këshillit. Shkresa e Prokurorisë së Përgjithshme, konkretisht është për rishikimin e afatit të ruajtjes së dosjes në kategoritë e çështjes për pushim çështjeje duke mbajtur në konsideratë afatet për parashikimin e ndjekjes penale të përcaktuar në nenet 66 dhe 67 të Kodit Penal. Parashikimi që ka pasur vendimi i Këshillit i mëparshëm ka qenë që “Seria 2-005”, Çështjet penale në të cilat është dhënë pafajësia”, afati ruajtjes ka qenë 10 vjet, sipas neneve të Kodit Penal është parashikuar ky ndryshim që,

- për veprat penale që parashikojnë dënim me burgim të përjetshëm, afati i ruajtjes 40 vjet;
- për veprat penale që parashikohet dënim jo më të ulët se dhjetë vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë, afati i ruajtjes 20 vjet;
- për veprat penale që parashikohet dënim nga pesë deri në dhjetë vjet burgim, afati i ruajtjes 10 vjet;
- për veprat penale që parashikohet dënim deri në pesë vjet burgim ose gjobë, afati i ruajtjes 5 vjet;
- për veprat penale që parashikohet dënim deri në dy vjet burgim, afati i ruajtjes 3 vjet;
- për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim me gjobë, afati i ruajtjes 2 vjet.

Si dhe “Seria 2-005, Çështjet penale në të cilat është vendosur pushimi i çështjes, afati i ruajtjes ka qenë 10 vjet dhe ndryshimi është ky:

- për veprat penale që parashikojnë dënim me burgim të përjetshëm, afati i ruajtjes 40 vjet;
- për veprat penale që parashikohet dënim jo më të ulët se dhjetë vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë, afati i ruajtjes 20 vjet;
- për veprat penale që parashikohet dënim nga pesë deri në dhjetë vjet burgim, afati i ruajtjes 10 vjet;
- për veprat penale që parashikohet dënim deri në pesë vjet burgim ose gjobë, afati i

- ruajtjes 5 vjet;
- për veprat penale që parashikohet dënim deri në dy vjet burgim, afati i ruajtjes 3 vjet;
 - për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim me gjobë, afati i ruajtjes 2 vjet.
- Këto janë ndryshimet e propozuara për ndryshimin e vendimit 426.
Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit Keli!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Pra thjesht ka ardhur si propozim i Prokurorisë.

(Nuk ka diskutime.)

Nëse jo, kalojmë në miratimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet ndryshimi i vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 426, datë 14.10.2022, “Për miratimin e listave tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve gjyqësore që arkivohen në gjykata”, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.01.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit { ... }, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 - 2016”, relatore znj. Irena Plaku.²

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Emona Muçi*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Irena Plaku*** (anëtare)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 6-ta sipas rendit të ditës. Shih procesverbalin e pikës së parë, pasi pikat nr. 3 dhe nr. 5 u shtynë dhe nuk u trajtuan, për rrjedhojë ndryshon renditja.

10. Markelian Koça (anëtar)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.

5. Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.

6. Përfaqësues i EU4Justice.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

8. BIRN.

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, relatore znj. Irena Plaku.

Naureda Llagami: Tashmë kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”. Shkurtimisht, duke qenë që edhe nga ana e gjyqtarit, nuk ka paraqitur kundërshtime, dhe ne jemi vënë në dijeni me projektraportin, shkurtimisht nga ana e relatores mbi çfarë përmban.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë, po ju parashtroj në mënyrë të përmbledhur projektraportin e vlerësimit të z. {...}. Ky i fundit është njoftuar për projektraportin. Nuk ka paraqitur kundërshtime. Gjithashtu është njoftuar për seancën e sotme dhe nuk ka kërkuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore.

Procedura e vlerësimit për gjyqtarin ka filluar me vendimin nr. 239, datë 30.06.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pas dërgimit të dosjes nga organet e rivlerësimit. Është bërë procedura e përcaktimit të hedhjes në short të relatorit dhe nëpunësit përgjegjës. Janë administruar të gjitha aktet e dosjes dhe burimet e vlerësimit. Konkretisht burimet e vlerësimit janë aktet e dosjes dhe dokumentet e përdorura në vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarit, konkretisht formulari i vetëdeklarimit, të dhënat e dosjes personale, të dhënat statistikore për periudhën e vlerësimit administruar në dosjen e rivlerësimit, dosjet e përzgjedhura me short (5 dosje nga KPK-ja dhe 3 dosje të zgjedhura nga gjyqtari), si dhe të dhënat arkivore të KLGJ-së, ku ka rezultuar se ka pasur tre ankesa, të dhënat të pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese, raporti i aftësive profesionale të hartuara nga KLGJ-ja, vendimi i KPK-së dhe KPA-së, si dhe çështjet e përzgjedhura me short. Deri në faqen 42 është bërë një përshkrim i detajuar i të gjitha burimeve të vlerësimit.

Po parashtroj në mënyrë të përmbledhur konkluzionet për katër kriteret e vlerësimit dhe treguesit përkatës. Konkretisht:

Aftësitë profesionale të gjyqtarit: Njohuritë ligjore – 1.A.A Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave - Në tërësi, nga analiza e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka aftësi të mira për identifikimin e qartë, të saktë dhe të kuptueshme të fakteve të çështjes, proces të cilin gjyqtari e arrin duke u bazuar shumë në pretendimet të palëve mbi rrethanat e faktit. Rezulton se gjyqtari jo gjithmonë përshkruan dhe analizon në mënyrë të qartë, koncize rrethanat dhe faktet e çështjes, si ato me natyrë procedurale dhe material, duke i integruar ato edhe me provat e marra në shqyrtim. Nga përmbajtja e vendimit kuptohet se përgjithësisht provat përshkruhen sipas përshkrimit dhe analizës që i ka bërë secila palë fakteve të çështjes në mbështetje të pretendimeve të tyre, duke mos dhënë kështu gjithmonë një panoramë të qartë të fakteve që kanë rezultuar nga shqyrtimi gjyqësor. Gjithashtu, rezultoi se gjyqtari ka aftësi të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose material që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes. Por jo gjithmonë konstatohet kujdes i gjyqtarit në

identifikimin, citimin dhe më pas analizimin e dispozitave që citon në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, pasi janë konstatuar mosidentifikim i qartë i ligjit, titullit apo numrit, i cili në një rast ka pasur mospërputhje, gjë që vështirëson kuptimin dhe qartësinë e vendimit, apo citimi i dispozitave të cilat nuk janë analizuar, apo citimi i ligjit në tërësi dhe jo i përmbajtjes së tyre.

Sa më sipër, lidhur me këtë tregues, aftësia e gjyqtarit është vlerësuar mbi mesatare duke e pikëzuar me 20 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes – Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka përgjithësisht aftësi mesatare në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjet procedurale të analizuar, ashtu edhe në lidhje me zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjeve objekt gjykimi. Gjyqtari, në disa vendime burim vlerësimi, citimin ose referimin në dispozita e shoqëron me interpretimin abstrakt dhe konkret, në aplikimin mbi faktin konkret apo për të mbështetur konkluzionin e arritur, interpretim i cili konstatohet kryesisht tek marrëdhëniet e punës. Por në disa vendime mungon tërësisht interpretimit i ligjit të cituar apo referuar nga gjyqtari në vendim, duke u arritur direkt në konkluzione apo duke bërë në disa raste vetëm analizë logjike të rrethanave të çështjes, por jo analizë ligjore. Përgjithësisht gjyqtari nuk bën analizë abstrakte të normës ligjore dhe shpeshherë citon disa norma ligjore njëherësh dhe del në konkluzion bazuar në këto dispozita, por pa i analizuar ato. Në disa nga çështjet burim vlerësimi, gjyqtari ka referuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese në mbështetje të argumenteve të tij lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit.

Pas analizimit të të dhënave vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është mesatare dhe duhet të pikëzohet me 15 pikë.

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit – Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari i kushton rëndësi arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë për lexuesin. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit të shprehur, përgjithësisht mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime logjike nga njëra pjesë tek tjetra, në shërbim të argumentimit

të çështjeve të ngritura prej tij për zgjidhjen, apo zgjidhjen tërësore.

Vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit - Gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit një strukturë relativisht të qëndrueshme dhe të organizuar. Gjyqtari ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkuese arsyetuese në nënndarje, të identifikuar në disa raste me tituj apo nëntituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese - arsyetuese, si dhe dispozitivin. Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit e çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit, etj. Siç është theksuar më sipër, në asnjë rast nuk është njoftuar dhe nuk është shënuar më pas si pjesëmarrës në gjykim Avokatura e Shtetit, sipas nenit 79/a të KPRC, përveçse në një vendim gjyqësor. Gjithashtu, gjyqtari nuk ka argumentuar njoftimin apo mosnjoftimin e këtij subjekti.

Pjesa përshkuese ndahet në paraqitjen e palës paditëse, faktin dhe rrethanat e provuara në gjykim, pretendimet dhe prapësimet e palëve, kuadrin ligjor, dispozitivin.

Në dispozitiv gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarit dhe sekretares gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve përgjithësisht është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim: disponimi i gjykatës mbi çdo kërkim të objektit të padisë. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi disponohet për të drejtën e ankimit sipas afateve ligjore ose për cilësinë e vendimit si i paankimueshëm. Në disa vendime konstatohet se gjyqtari nuk ka disponuar për ligjërimin e masës së sigurimit të padisë të marrë gjatë gjyqimit, sipas nenit 212 të KPRC, konkretisht janë cituar dy vendime gjyqësore.

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi mbi mesatare në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, pasi megjithëse ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, por nuk konstatohet e njëjta aftësi e strukturimit të mendimit në

aspektin e përmbajtjes së tij. Gjyqtari ndjek përgjithësisht një strukturë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit apo të vlerësuar kryesisht nga gjykata, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e palëve ndërgjyqëse, të cilat janë përgjithësisht janë pjesë e rrethanave të faktit dhe jo të ndarë më vete, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë të tij, përfundimet e arritura. Konstatohet së në disa vendime, për çdo nënndarje apo njësi e vendimit të jenë vendosur titujt përkatës dhe fjali tematike, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit si dhe në shërbim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së tij duke mundësuar përgjithësisht lexim të organizuar. Por nuk konstatohet e njëjta qartësi në pjesën arsyetuese të vendimit, në lidhje me strukturimin e mendimit në paragrafë që duhet të vijjnë në rrjedhë logjike midis tyre. Gjithashtu, edhe pjesa e fundit (dispozitivi) nuk është i plotë në lidhje me disponimin e gjykatës për rastet kur gjatë gjykimit ka marrë në shqyrtim dhe ka pranuar kërkesën e palëve për sigurimin e padisë, pasi nuk ka disponuar për ligjërimin e saj.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është mbi mesatare duke e pikëzuar me 8 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik – Referuar burimeve të vlerësimit rezulton vlerësuar në tërësinë e tyre në raport me natyrën e çështjeve, se gjyqtari ka aftësi mesatare në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Në disa vendime burim vlerësimi, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe mbështetet në pak raste në qëndrimet e praktikës gjyqësore, megjithëse nuk spikat interpretimi individual i ligjit dhe as argumentimi logjik. Duke i vlerësuar vendimet burim vlerësimi në tërësinë e tyre, nuk evidentohet e njëjta shkallë kujdesi në drejtim të analizë dhe argumentit logjik, pasi në një pjesë të vendimeve mungon komponenti analizës juridike të ligjit të zbatueshëm dhe se si ky ligj gjen zbatim mbi faktet konkrete. Gjithsesi gjyqtari bën më shumë një analizë të fakteve sesa një analizë të ligjit mbi faktet. Gjithashtu edhe pse konstatohet se disa vendime janë gjithëpërfshirëse në raport me kërkesat e palëve, të cilat marrin përgjigje të argumentuar, kjo e fundit jo gjithmonë bazohet në një vlerësim të pavarur të pretendimeve të ngritur bazuar në ligjin përkatës që gjen zbatim dhe faktet konkrete të

çështjes, duke dalë direkt në konkluzionin për bazueshmërinë ose jo të kërimit përkatës në çështjet e marra në vlerësim. Ndërsa në disa vendime, gjyqtari nuk i ka marrë në analizë pretendimet e palëve, si në raport me bazueshmërinë e tyre në ligj ashtu edhe në raport me faktet e çështjes, megjithëse për ato gjyqtari ka disponuar përfundimisht.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është mesatare duke e pikëzuar me 5 pikë.

Atëherë, propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësia profesionale e gjyqtarit” është 73 pikë, niveli i vlerësimit "Shumë mirë".

Aftësia organizative e gjyqtarit, konkretisht për treguesin 2.A.A Respektimi i afateve ligjore. Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuara për të cilat ligji ka parashikuar afat shqyrtimi si dhe për shqyrtimin e kërkesave me afat ligjor, të paraqitura së bashku me padinë apo gjatë gjykimit, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

Për sa më sipër aftësia e tij vlerësohet shumë e lartë duke e pikëzuar me 15 pikë, pasi përqindja e çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor është 0 %.

2.A.B Plotësimi i standardeve minimale kohore - Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, nuk i referohemi të dhënave statistikore por vetëm dosjeve të cilat janë përzgjedhur me short dhe kanë të dhëna për të identifikuar plotësimin e standardit, konkretisht 1 çështjeve të përzgjedhura me short. Në projektraport është përshkruar afati brenda së cilës është gjykuar çdo çështje. Referuar afatit 87–ditor të llogaritur më lart, për sa kohë që kemi çështje administrative, referuar të gjitha rregullave dhe ligjit të zbatueshëm për gjykimin e çështjeve administrative rezulton se për 11 çështje për të cilat zbatohet standardi sipas përlllogaritjeve matematikore, të gjitha kanë përfunduar brenda afatit. Sa më sipër, për këtë tregues, gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi të gjitha çështjet janë shqyrtuar brenda standardeve minimale.

2.A.C Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje – Konkretisht për kategorinë e çështjeve administrative me palë kundërshtare: koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, duke iu referuar kohëzgjatjes së 8 çështjeve të kësaj kategorie, rezulton të jetë 35 ditë, apo 1 muaj e 5 ditë, më e shkurtër se standardi minimal kohor në fuqi. Për kategorinë e

çështjeve “marrëdhënie pune”, është 33.7 ditë. Sa më sipër rezulton se koha mesatare është brenda standardit minimal për të dyja kategoritë e çështjeve. Për sa më sipër gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.

2.A.Ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve – Ka rezultuar se gjatë periudhës trevjeçare të vlerësimit gjyqtarit ka gjykuar 4030 çështje gjithsej, nga të cilat 714 çështje administrative, 312 marrëdhënie pune, 74 çështje të tjera dhe 2930 urdhra ekzekutimi, për çdo vit.

Referuar të dhënave statistikore ka rezultuar se rendimenti është llogaritur me 95.8% e cila është nxjerrë bazuar në deklaratimet e vetë gjyqtarit. Sipas metodologjisë së pikëzimit kjo përqindje pikëzohet me 8 pikë. Pasur parasysh ngarkesën e gjyqtarit për periudhën e vlerësimit nga e cila rezulton se e ka tejkaluar standardin minimal në fuqi mbi masën e 128% në ngarkesën si gjyqtar por duke iu referuar edhe ngarkesës si kryetar ka rezultuar se e ka tejkaluar mbi 400%.

Pasur parasysh këto rrethana vlerësohet se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë duke e rritur në 10 pikë.

2.A.D Koha mesatare e arsyetimit të vendimeve – Edhe në këtë rast burime të vlerësimit janë 11 çështjet e përzgjedhura me short dhe një çështje e marrë në shqyrtim për shkak të ankesës si dhe i është evidentuar gjyqtarit për efekt të vlerësimit, nga ku ka rezultuar se (i) për kategorinë “çështje administrative me palë kundërshtarë, koha mesatare është 5.2 ditë, brenda 7 ditëve. Ndërsa për kategorinë e marrëdhënies së punës, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 21 ditë, duke e tejkaluar afatin 7-ditorë, me 14 ditë, ku në tejkalimin e këtij afati ka ndikuar vetëm një dosje, pasi po të zbresim këtë dosje, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit është më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Referuar metodologjisë së pikëzimit, pasur parasysh ngarkesën e gjyqtarit për periudhën e vlerësimit ku ka rezultuar se ka dhënë 4030 vendime, nga të cilat 1026 çështje me palë kundërshtarë, vlerësohet se gjyqtari për këtë tregues duhet të vlerësohet me një nivel më të lartë pikëzimi duke arritur në nivelin maksimal me 15 pikë.

Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore – Edhe këtu janë analizuar të gjitha dosjet burim vlerësimi nga ka rezultuar se numri i seancave duke iu referuar 11

çështjeve është 2.36 (brenda 3 seancave). Rezulton se shkaqet e shtyrjeve të seancave kanë qenë të përligjura përgjithësisht. Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, duke qenë se numri mesatar i seancave është 2.36 seanca në kategorinë e çështjeve me palë kundërshtare dhe faktit se shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është shumë e lartë, gjyqtari duhet të pikëzohet me 15 pikë.

2.B.B Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor – Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short, vlerësim i cili i përket kategorive me palë kundërshtare, lidhur me kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin rezulton si më poshtë:

Gjyqtari ka vënë në lëvizje dosjet brenda afatit. Është bërë një analizë e gjerë këtu lidhur me këtë tregues.

Në konkluzion është arritur: Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie mbi mesatare në këtë tregues, evidentuar në shpejtësinë dhe korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale duke respektuar përgjithësisht standardet e procesit të rregullt ligjor. Por nuk konstatohet i njëjti kujdes nga gjyqtari në raport me kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve procedurale sipas rregullave procedurale të parashikuara në ligjin nr.49/2012 si dhe në Kodin e Procedurës Civile, që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimeve përgatitore efektive, caktimin e ekspertit, njoftimin e kërkesë padisë dhe akteve avokaturës së shtetit sipas nenit 79/a të K.Pr.Civile, planifikimit dhe zhvillimi i seancave përgatitore kur është e nevojshme, pasi është konstatuar që gjyqtari ekspertin e ka caktuar në seancë gjyqësore, seancat përgatitore kanë qenë joefektive dhe nuk ishte thirrur Avokatura e Shtetit.

Për sa më sipër është vlerësuar se aftësia për këtë tregues është mbi mesatare, duke e pikëzuar me 16 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen – Në tërësi dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi. Për sa më sipër është vlerësuar se aftësia për këtë tregues është shumë e lartë duke e pikëzuar me 5 pikë.

Sa i përket treguesit 2.A.B Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes - Në tërësi, dokumentacioni i dosjeve të vëzhguara është i saktë dhe i plotë, nuk konstatohen mungesa aktesh dhe nuk konstatohet në dosje dokumentacion i cili nuk i përket çështjeve konkrete. Për sa më sipër, për këtë tregues është vlerësuar aftësia e tij shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për “Aftësia organizative e gjyqtarit” janë pikët 96, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket kriterit “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” – Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion – Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion dhe për këtë arsye propozohet pikëzimi me 35 pikë.

Integriteti i gjyqtarës – Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti – Edhe për këtë tregues rezulton se aftësia e tij është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet me 40 pikë.

Paanësia e gjyqtarit – Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese – Nga të dhënat burim vlerësimi nuk rezulton se gjyqtari të ketë përdorur gjuhë diskriminuese në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në komunikim me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, vlerësohet se aftësia e tij është shumë të lartë duke e pikëzuar me 10 pikë.

Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtim – Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit. Për këto arsye, propozohet pikëzimi i tij me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe i pikëzimit për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” është pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Për sa i përket kriterit “Aftësia profesionale dhe angazhimi profesional” – Aftësia e komunikimit – Rezulton se gjyqtari aftësinë për këtë tregues e ka shumë të lartë.

4.A.B. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave profesionale – Nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektimin e konfidencialitetit dhe të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Për këtë arsye vlerësohet se aftësia e tij është shumë e lartë duke e pikëzuar me 15 pikë.

E njëjta shkallë aftësie rezulton edhe tek 4.B. Aftësia për të bashkëpunuar – 4.B.A Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, 4.B.B Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën, duke propozuar përkatësisht me 15 dhe 10 pikë, niveli maksimal për të dy treguesit.

4.C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera - 4.C.A. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues – Rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit ka marrë pjesë në 16 aktivitete trajnuese të zhvilluara për 21 ditë. Për sa më sipër për këtë tregues propozohet pikëzimi i tij me 20 pikë.

4.C.B Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët.. – nuk ka të dhëna lidhur me këtë tregues. Për këtë arsye, sipas metodologjisë së pikëzimit propozohet pikëzimi i tij me 3 pikë.

4.C.C Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale - edhe për këtë tregues nuk ka të dhëna të angazhimit të gjyqtarit. Për sa më sipër propozohet pikëzimi i tij me 3 pikë.

Sa i përket treguesit 4.C.Ç Publikimet ligjore, nuk rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari të ketë publikime ligjore, për këtë arsye pikëzohet me 0 pikë.

Atëherë, propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin e katërt është pikët 100 (*lapsus pasi janë 91*) pikë, niveli "Shkëlqyeshëm".

Niveli i vlerësimit për çdo kriter vlerësimi është si më poshtë:

Aftësia profesionale e gjyqtarit, 73 pikë, niveli i vlerësimit "Shumë mirë".

Aftësia organizative, 96 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësia personale dhe angazhimi profesional, pikët 91, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Vlerësimi i përgjithshëm është 360 pikë, niveli i vlerësimit "Shumë mirë".
Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kemi diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Nëse jo, kalojmë në votimin e projektraportit sipas propozimit të bërë?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Miratimin e raportit të vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi për gjyqtarin {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016. Niveli i përgjithshëm "Shumë mirë", 360 pikë.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar. [...].

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.01.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2020-2022”, relatore znj. Yllka Rupa.³

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|---------------------------------|
| 1. Naureda Llagami | <i>(kryetare)</i> |
| 2. Ilir Rusi | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 3. Klodian Kurushi | <i>(anëtar)</i> |
| 4. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 5. Emona Muçi | <i>(anëtare)</i> |
| 6. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |
| 8. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 9. Gentiana Muçaj | <i>(anëtare)</i> |
| 10. Markelian Koça | <i>(anëtar)</i> |

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 7-ta sipas rendit të ditës. Shih procesverbalin e pikes së parë, pasi pikat nr. 3 dhe nr. 5 u shtynë dhe nuk u trajtuan, për rrjedhojë ndryshon renditja.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
- 6. Përfaqësues i EU4Justice.*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 8. BIRN.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2020-2022”, relatore znj. Yllka Rupa.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë edhe ky me shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...} për periudhën 2020-2022, me relatore Yllka Rupa.

Yllka Rupa: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Në cilësinë e relatores në procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, do paraqes projektraportin e vlerësimit. Në projektraport paraqitet e plotë procedura e ndjekur, paraqitet e detajuar analiza e të dhënave të dala nga burimet e vlerësimit dhe duke qenë se të gjithë anëtarët janë njohur me projektraportin, po paraqes në mënyrë të përmbledhur rezultatet e vlerësimit dhe pikëzimit për gjithsecilit nga katër kriteret.

Lidhur me kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtares”, për të gjithë treguesit,

gjqtarja është vlerësuar në nivelin maksimal dhe pikëzimin maksimal, për arsye sepse ka aftësi për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe konfliktin e normave. Aftësi shumë të mira për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes. Evidentohet se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë, kuptueshmërisë dhe koncizitetit. Gjithashtu ka një strukturë të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit gjyqësor dhe cilësi të analizës dhe argumentimit logjik.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtares” propozohet të jetë niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Lidhur me “Aftësitë organizative të gjyqtares”, të cilat vlerësohen me qëllim për të kuptuar sa mirë gjyqtari organizon, menaxhon dhe kontrollon efektivisht procedurat gjyqësore. Janë analizuar aftësitë e gjyqtares për të përballuar ngarkesën në punë dhe aftësitë për të kryer procedura gjyqësore.

Lidhur me “Respektimin e afateve ligjore”, sipas burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik dhe tabelat me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 299 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, 85 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (85 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (299 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 28.4 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Referuar vetëvlerësimit të gjyqtarit sipas formularit të integruar të vlerësimit, i cili përbën burim vlerësimi lidhur me këtë tregues rezulton se subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “Respektimi i afateve ligjore” në shkallë shumë të lartë duke parashikuar disa shkaqe objektive të cilat kanë ndikuar në ecurinë e gjykimit të çështjeve dhe kanë afektuar në aspektin e respektimit të afateve ligjore. Konkretisht gjyqtarja parashikon si të tilla: ngarkesën në punë dhe kompleksitetin e çështjeve, shkarkimin e një gjyqtareje për shkak të vetingut dhe rishortimin e çështjeve, pezullimin e veprimtarisë gjyqësore në mars-qershor 2020 për shkak të pandemisë, gjendjen e shtatzënisë nga muaji korrik 2020 deri në 2021, transferimin në vitin 2021 të një gjyqtari në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe rishortimin e çështjeve, si dhe faktorë të tjerë që kanë ndikuar në mos

gjykimin e çështjeve brenda afateve ligjore të cilat pasqyrohen në mënyrë të detajuar në projektraport.

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat nga burimet e tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 85 çështjet e shqyrtuara jashtë afateve ligjore, rezulton se: në disa prej tyre afati ligjor është tejkaluar në një kohë relativisht të shkurtër, me 1, 2 ose 3 ditë, duke përjashtuar çështjet në të cilat afati ligjor është tejkaluar në kohë relativisht të shkurtër, si dhe çështjet të cilat vonesat në shqyrtim ka ardhur edhe si pasojë e arsyeve të lartpërmendura, numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit rezulton të jetë 68 çështje. Për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, rezulton të jetë 22.7% të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor. Kjo përqindje e çështjeve, sipas metodologjisë, pikëzohet me 9 pikë.

Lidhur me këtë tregues, në metodologji është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, dhe aspekte të tjera. Në këto kushte propozoj që lidhur me këtë komponent gjyqtari të vlerësohet në nivelin e 15 pikëve.

Për sa i takon “Plotësimin të standardeve minimale kohore”, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raport dhe tabela me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit 2020-2022, gjyqtarja subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 731 çështje për të cilat janë parashikuar afate orientuese për standardin minimal kohor, nga të cilat në total 258 jashtë këtij afati. Rrjedhimisht, gjyqtarja subjekt vlerësimi rezulton të ketë gjykuar 35% të çështjeve jashtë standardit minimal kohor në fuqi. Bazuar në metodologjinë e pikëzimit, duke përjashtuar nga përllogaritja afatin e gjykimit të pushimeve vjetore dhe ditët e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore, rezulton se disa prej këtyre çështjeve do të kishin përfunduar brenda standardeve minimale kohore.

Në projektraport pasqyrohet analiza e plotë e kësaj situatë sipas tabelave

përkatëse për çdo vit vlerësimi dhe rezulton se nga 731 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit për të cilat zbatohet standard minimal kohor, 190 prej tyre ose 25.9% janë gjykuar jashtë standardit minimal kohor. Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe analizës matematikore e logjike të tyre si dhe duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës siç kanë qenë shkaqet shëndetësorë apo periudha e pandemisë, periudhë në të cilën veprimtaria gjyqësore ka qenë e pezulluar, vlerësoj se për këtë tregues, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 4 pikë.

Në lidhje me “Kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, nga tërësi e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, pasqyruar në raportin analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar për shumicën e kategorive të çështjeve. Propozohet niveli i vlerësimit lidhur me këtë tregues, duke pasur parasysh edhe përcaktimet e metodologjisë, me 5 pikë.

Në lidhje me “Rendimentin e përfundimit të çështjeve”, duke iu referuar burimeve të vlerësimit rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit rezulton 105%, për këtë arsye gjyqtarja propozohet të vlerësohet me 10 pikë.

Për sa i takon “Kohës mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar”, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar, duhet të klasifikohet më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve, çka bën që gjyqtarja të pikëzohet në nivelin e 6 pikëve.

Për sa i takon “Aftësisë për të kryer procedura gjyqësore”, “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 2 seanca dhe gjyqtarja në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore. Për këtë arsye propozohet niveli i pikëzimit me 15 pikë.

Në lidhje me “Kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale”, në tërësi rezulton

se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë. Propozohet niveli i vlerësimit me 20 pikë.

Për sa i takon “Aftësisë për të administruar dosjen gjyqësore” si në aspektin e “Rregullshmërisë së dokumentacionit të dosjes” ashtu edhe sa i përket “Saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit të dosjes”, paraqitet në nivel të lartë gjyqtarja dhe propozohet niveli i pikëzimit 5 dhe 10 pikë.

Kështu që propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësitë organizative të gjyqtarës” propozohet të jetë niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 90.

Lidhur me kriterin e “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”, për të gjithë treguesit e këtij kriteri gjyqtarja propozohet të vlerësohet në nivelin maksimal dhe pikët maksimale për arsye sepse shfaq etikë në punë, ka angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion. Sipas burimeve të vlerësimit ndaj gjyqtarës nuk janë regjistruar në ILD asnjë ankesë për periudhën e vlerësimit. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjen e gjykimit, si dhe të dhënave që rezultojnë nga vetëvlerësimi i gjyqtarës. Po ashtu numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës është i pakonsiderueshëm duke qenë se në periudhën trevjeçare ka vetëm dy kërkesa të pranuar për përjashtimin e gjyqtarës nga gjykimi kështu që në lidhje me këtë kriter propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i takon “Aftësi personale dhe angazhimi profesional”, gjyqtarja rezulton të ketë komunikimin të qartë dhe transparent dhe lidhur me këtë tregues propozohet niveli i pikëzimit 25. Respekton konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në të gjitha rastet kur vihet në dijeni për shkak të funksionit të tyre. Propozohet niveli i pikëzimit 15 për këtë tregues.

Ka aftësi për të bashkëpunuar me kolegët dhe me administratën gjyqësore kështu që për të dy këto tregues propozohet niveli i pikëzimit përkatësisht 15 pikë dhe 10 pikë.

Lidhur me pjesëmarrjen e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë

tregues rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 12 aktivitete të zhvilluara për 17 ditë, kohëzgjatja e të cilave është brenda kufijve 15-120 ditë në të gjithë periudhën 3-vjeçare. Lidhur me këtë tregues propozohet niveli i pikëzimit me 20 pikë.

Për sa i përket “Disponueshmërisë së gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese, kështu vlerësohet me 3 pikë.

Gjithashtu “Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë” nuk është e dokumentuar kështu që propozohet vlerësimi i saj lidhur me këtë tregues me 3 pikë.

Gjithashtu nuk rezulton të ketë publikime ligjore dhe akademike. Kështu që, lidhur me këtë tregues vlerësohet me 0 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, për gjyqtaren, propozohet të jetë niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 91.

Në mënyrë të përmbledhur propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi për gjyqtaren {...} propozohet të jetë si më poshtë:

Aftësitë profesionale të gjyqtarit, 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësitë organizative të gjyqtarit, 90 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, pikët 91, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit për gjyqtaren propozohet të jetë pikët 381, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Rupa!

Atëherë, duke qenë se s’kemi kundërshtime edhe nga ana e magjistrates, nga kolegët nëse s’kemi diskutime ose propozime, kalojmë në votim projekt-aktin sipas

propozimit të sjellë nga relatorja.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Miratimin e raportit të vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtaren {...}, për periudhën 2020-2022. Niveli i përgjithshëm "Shkëlqyeshëm", 381 pikë.

Ky raport vlerësimi i miratuar i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.01.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, i përgatitur nga Komisioni Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, raportore znj. Emona Muçi.⁴

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Emona Muçi | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Irena Plaku | (anëtare) |

⁴ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 8-ta sipas rendit të ditës. Shih procesverbalin e pikes së parë, pasi pikat nr. 3 dhe nr. 5 u shtynë dhe nuk u trajtuan, për rrjedhojë ndryshon renditja. 40

- | | |
|---------------------------|------------------|
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
- 6. Përfaqësues i EU4Justice.*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 8. BIRN.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtim i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, i përgatitur nga Komisioni Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, relatores znj. Emona Muçi.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-aktet e tjera që në fakt i kemi shorte. Fillojmë me projekt-aktin e parë. Administrata është disponibël. Kemi “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, ky projekt-akt vjen nga Komisioni Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, do e relatojë zonja Emona Muçi.

Emona Muçi: Këshilli i Lartë Gjyqësor, në zbatim të ligjit ka filluar me prioritet procesin e vlerësimit etik-profesional me qëllim gradimi gjyqtarët që e kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit.

Rezulton se tre nga gjyqtarët të cilëve u ka mbaruar mandati si anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe janë kthyer si gjyqtarë efektivë, (*procedura e vlerësimit*) ishte pezulluar dhe me ardhjen e dosjeve dhe me anashkalimin e kësaj pengese kemi vlerësuar që të zhvillohet procesi i shortimit të tyre dhe konkretisht:

1. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, është konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. {...}, datë 25.06.2018, vendim i cili ka marrë formë të prerë për shkak mosankimi në datë 17.08.2018.

2. Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. {...}, datë 01.08.2018, vendim i cili ka marrë formë të prerë për shkak mosankimi në datë 24.09.2018.

3. Znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. {...}, datë 04.06.2018, vendim i cili ka marrë formë të prerë për shkak mosankimi në datë 24.07.2018.

Dosjet nga KPK janë përcjellë Këshillit me shkresat nr. {...}prot., datë 11.05.2023 dhe 2070 prot, datë 12.05.2023 respektivisht për gjyqtarët {...}, {...}, {...}.

Për këtë arsye, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë profesionale ka përgatitur projektvendimin për fillimin e procedurës së vlerësimit për përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) për 3 gjyqtarët.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) për gjyqtarët të cilët kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe për të cilët janë dorëzuar në vijim nga organet e rivlerësimit dosjet me aktet e vlerësimit profesional që janë marrë gjatë procesit të rivlerësimit.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet caktimi i relatores dhe nëpunëses

përgjegjëse për vlerësimin për secilin gjyqtar, proces i cili realizohet nëpërmjet shortit midis anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale znj. Emona Muçi, znj. Irena Plaku dhe znj. Yllka Rupa, me një shpërndarje ngarkese të barabartë, me nga 1 (një) vlerësim secila. Ndërsa për përzgjedhjen e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, shorti do të realizohet ndërmjet 2 (dy) nëpunësve të Njësisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional, të angazhuar deri tani me vlerësimet periodike të gjyqtarëve, sipas nenit 12, pika 2 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, znj. Esmerilda Habili dhe znj. Erlanda Agaj me një ngarkesë pune të tillë: znj. Esmerilda Habili 1 (një) vlerësim dhe znj. Erlanda Agaj 2 (dy) vlerësime.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Filloni procedurën e shortit.

Në një nga enët do të hidhen emrat e gjyqtarëve.

Në enën tjetër emrat e relatorëve dhe në enën tjetër emrat e nëpunësve.

Pse duhet të bëhen kaq shumë shorte kur Esmerildën ne e kemi fakt të njohur. Unë do të kisha si propozim t’ia kalonim të gjitha znj. Agaj, siç e bëmë ne tek komisioni ynë, e idenë që kur të na vijnë të rejat, edhe ajo do të ngarkohet më pak duke parë ngarkesën ose do i ndajmë midis atyre.

Emona Muçi: E kemi diskutuar, edhe me Irenën e kam diskutuar, edhe me gocat. Problemi është që Erlanda do të ngarkohet me shumë procedura. Do jetë e pamundur efektivisht për punën e saj, ndërkohë që gocat e reja do të jenë me një ngarkesë minimale. Për të shpërndarë ngarkesën më vonë... Të ketë Esmerilda disa materiale të cilat do t’iu kalojnë të tjerëve pasi ato të pranohen. Ky ka qenë si qëllim.

Naureda Llagami: Vazhdojmë pra hedhjen e shortit.

Procedura e shortit si vijon:

Në enën e parë të qelqit futen shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve: znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...}.

Në enën e dytë të qelqit futen shiritata e letrës me emrat e relatorëve: znj. Emona Muçi, znj. Irena Plaku dhe znj. Yllka Rupa.

Në enën e tretë të qelqit futen shiritat e letrës me emrat e nëpunësve: znj. Esmerilda Habili, znj. Erlanda Agaj (2 shirita letre).

Procedura e përzgjedhjes si më poshtë:

Përzgjidhet emri i gjyqtarit, znj. {...}. Për znj. Shehu përzgjidhet relatore znj. Irena Plaku dhe nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Përzgjidhet emri i gjyqtarit, znj. {...}. Për znj. Ukperaj përzgjidhet relatore znj. Emona Muçi dhe nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Përzgjidhet emri i gjyqtarit, znj. {...}. Për z. Hallunaj përzgjidhet relatore znj. Yllka Rupa dhe nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim projekt-aktin?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për të cilët janë dorëzuar në vijim nga organet e rivlerësimit, dosjet

me aktet e vlerësimit profesional.

2. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

i) Për gjyqtaren znj. {...} - Relatore znj. Emona Muçi - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Esmerilda Habili;

ii) Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Yllka Rupa - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Erlanda Agaj;

iii) Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Erlanda Agaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.01.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për zëvendësimin e nëpunëses përgjegjëse për vlerësim znj. Gilda Hoxha në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”, i përgatitur nga Komisioni Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, relatore znj. Emona Muçi.⁵

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Illir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Emona Muçi* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Irena Plaku* (anëtare)
8. *Alban Toro* (anëtar)

⁵ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 9-ta sipas rendit të ditës. Shih procesverbalin e pikes së parë, pasi pikat nr. 3 dhe nr. 5 u shtynë dhe nuk u trajtuan, për rrjedhojë ndryshon renditja.

9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
10. *Markelian Koça* (anëtar)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
6. *Përfaqësues i EU4Justice.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për zëvendësimin e nëpunëses përgjegjëse për vlerësim znj. {...} në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”, i përgatitur nga Komisioni Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, relatore znj. Emona Muçi.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës i cili ka të bëjë me zëvendësimin e nëpunëses përgjegjëse për vlerësim znj. {...} në të gjitha procedurat ku ajo është si nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin.

Emona Muçi: Atëherë, ne si Komision kemi propozuar një projektvendim në lidhje me zëvendësimin e nëpunëses përgjegjëse për vlerësimin znj. {...} në të gjitha procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të cilat ajo kishte gjatë kohës së komandimit pranë këtij Këshilli.

Duke mbajtur në vëmendje faktin që njësia e vlerësimit është e përbërë aktualisht

nga znj. Esmerilda Habili dhe Erlanda Agaj, ndërkohë që pritet që të nisë procedura për rekrutimin edhe të kandidatëve të tjerë të cilët do të aplikojnë pranë kësaj njësie e cila shumë shpejt, javës tjetër ndoshta mund të bëhet gati (si bashkëpropozim), ndërkohë që duke mbajtur në vëmendje edhe faktin që zonja Esmerilda Habili në muajin mars do të mbarojë afatin e komandimit, vlerësoj që ky projektvendim, ky relacion të shtyhet në një mbledhje tjetër ku të jenë të përfshirë të gjithë kandidatët të cilët do të bëhen pjesë e Këshillit dhe të njësisë.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, e shtyjme për një mbledhje tjetër.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.01.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023”, i përgatitur nga Komisioni Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, relatore znj. Emona Muçi.⁶

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Naureda Llagami** (kryetare)
2. **Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
3. **Klodian Kurushi** (anëtar)
4. **Fatmira Luli** (anëtare)
5. **Emona Muçi** (anëtare)
6. **Ridvan Hado** (anëtar)
7. **Irena Plaku** (anëtare)
8. **Alban Toro** (anëtar)

⁶ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 10-ta sipas rendit të ditës. Shih procesverbalin e pikes së parë, pasi pikat nr. 3 dhe nr. 5 u shtynë dhe nuk u trajtuan, për rrjedhojë ndryshon renditja.

9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
10. *Markelian Koça* (anëtar)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
6. *Përfaqësues i EU4Justice.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023”, i përgatitur nga Komisioni Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, relatores znj. Emona Muçi.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti për ndryshimin në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023.

Emona Muçi: Përsëri ne si Komision kemi propozuar në lidhje me një ndryshim në listën e gjyqtarëve, të kondicionuar nga fakti që njëri nga gjyqtarët që ishte caktuar me vendimin nr. 466, datë 25.07.2023, i cili ka përcaktuar gjykatat dhe gjyqtarët udhëheqës gjatë praktikës profesionale për kandidatët për magjistratë, është shkarkuar në datën 19.01.2024 dhe kemi vlerësuar që kandidatët për magjistratë të cilët kanë qenë duke

zhvilluar praktikën pranë këtij gjyqtari të caktohen... pra të bëhet zëvendësimi i gjyqtarëve udhëheqës të tyre.

Ne si Komision kemi propozuar që në pikën 1 të projektvendimit 466, 25.07.2023, në lidhje me kandidatët për magistratë të vitit akademik 2023-2024, duke zëvendësuar gjyqtarin udhëheqës z. {...} me gjyqtarët:

i) znj. {...}, në cilësinë e gjyqtares udhëheqëse të kandidatës për magistratë znj. Eda Gjovari, për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2023 – shkurt 2024);

ii) z. {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatës për magistratë znj. Esmeralda Shehu, për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2024);

iii) z. {...} në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatës për magistratë znj. Matilda Çela, për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2023 – shkurt 2024) dhe në cilësinë e gjyqëtarit udhëheqës për kandidatin për magistrat z. {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2024).

Në pikën 2 të projektvendimit parashikohet njoftimi i Shkollës së Magistraturës, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe gjyqtarëve z. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe z. {...} .

Së fundi parashikohet momenti i hyrjes në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit referuar parashikimeve të ligjit, nenit 98, pika 3 të ligjit 115/2016.

Bashkëlidhur projektvendimit është edhe tabela me emrat e gjyqtarëve udhëheqës si dhe të kandidatëve për magistratë për vitin 2023-2024.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Nëse kemi diskutime?

Jo?

Kalojmë në votim të projekt-aktit?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për ndryshimin në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.01.2024)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor nr. 1/2024, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).⁷

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor nr. 2/2024, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:17 dhe mbaroi në orën 12:36.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)

⁷ Këto çështje ishin parashikuar të trajtoheshin 11 dhe 12 sipas rendit të ditës. Shih procesverbalin e pikës së parë, pasi pikat nr. 3 dhe nr. 5 u shtynë dhe nuk u trajtuan, për rrjedhojë ndryshon renditja. 53

- | | |
|---------------------------|------------------|
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
- 6. Përfaqësues i EU4Justice.*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 8. BIRN.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor nr. 1/2024, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor nr. 2/2024, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të

Përgjithshëm Durrës”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

Naureda Llagami: Kalojmë tani në dy projekt-aktet e fundit, të cilët na vijnë nga Komisioni i Disiplinës dhe që kanë të bëjnë me caktimin e anëtarit relator për dy procedura që janë nisur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Për më shumë detaje, fjalën ia jap kryetarit të Komisionit, z. Hado.

(Fjalën e merr relatori z. Hado për të relatuar relacionin e parë.)

Ridvan Hado: Faleminderit!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 16.01.2024 është depozituar kërkesa e ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në këtë kërkesë, Inspektori i Lartë kërkon apo propozon caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” ndaj magjistrates znj. {...} sipas parashikimeve të nenit 105, pika 1, shkronja “dh” dhe 111, të ligjit 96/2016 “Për statusin”.

Në referim të nenit 63 të ligjit nr. 115/2016 “Për qeverisjen”, të ndryshuar, nga ana e Këshillit duhet të procedohet me hedhjen e shortit për caktimin e relatorit. Në referim të nenit 16 të Rregullores “Për procedurat disiplinore”, propozohet që të marrin pjesë tre anëtarë pasi kjo dispozitë e rregullores “Për procedurat disiplinore” parashikon që nuk mund të marrin pjesë më pak se tre anëtarë. Konkretisht propozohet që anëtarët e përhershëm të marrin pjesë në short: Ridvan Hado, Ilir Rusi dhe Gentiana Muçaj.

Nga sa më sipër, Komisioni Disiplinor i propozon mbledhjes plenare zhvillimin e procedurës për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2024, të filluar ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë vijojmë me hedhjen e shortit sipas udhëzimeve që dha kryetari i Komisionit.

Procedura e shortit si vijon:

Në enën e qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e relatorëve: z. Ridvan Hado, z. Ilir Rusi, znj. Gentiana Muçaj.

Procedura e përzgjedhjes si më poshtë:

Për procedimin nr. 1/2024, relator përzgjidhet znj. Gentiana Muçaj.

(Fjalën e merr relatori z. Hado për të relatuar relacionin e dytë.)

Ridvan Hado: Po ashtu, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në datën 19.01.2024, nga ILD-ja është paraqitur kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në kërkesën e sipërcituar ka kërkuar caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” të magjistrates {...}, sipas parashikimeve të nenit 104, pika 3 dhe 111, pika 1, shkronja “b” të ligjit 96/2016 “Për statusin”.

Në referim të nenit 63 të ligjit nr. 115/2016 “Për qeverisjen”, të ndryshuar, nga duhet të proceduar ana e Këshilli me hedhjen e shortit për caktimin e relatorit. Në referim të nenit 16 të Rregullores, shorti do të hidhet ndërmjet anëtarëve të përhershëm, pra ndërmjet Ridvan Hado, Ilir Rusi dhe Gentiana Muçaj, pasi referuar dispozitës që sapo citova, nuk mund të marrin pjesë më pak se tre anëtarë në short.

Nga sa më sipër, i propozojmë mbledhjes plenare, si Komision Disiplinor, zhvillimin e procedurës për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 2/2024, të filluar ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë të vijojë procedura e shortit sipas udhëzimeve që shpjegoi zoti Hado.

Procedura e shortit si vijon:

Në enën e qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e relatorëve: z. Ridvan Hado, z. Ilir Rusi, znj. Gentiana Muçaj.

Procedura e përzgjedhjes si më poshtë:

Për procedimin nr. 2/2024, relator përzgjidhet z. Ilir Rusi.

Naureda Llagami: Atëherë, me mbarimin e shortit, Këshilli vendosi:

Caktimin e anëtarit me short të Komisionit Disiplinor për procedimin disiplinor 2/2024, ndaj magjistrates {...}, z. Ilir Rusi. Jemi dakord? Kalojmë në votim? (*Për shkak edhe të rrjedhës së trajtimit të dy çështjeve së bashku, duke pasur të njëjtin objekt, miratimi gjithashtu do të ishte për të dy shortet.*)

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, me kaq po e mbyllim mbledhjen plenare.

Punë të mbarë.

* * *

(Pikat 9 - 10 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor